



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:285147

Datë: 27.04.2022

Numri i dokumentit: 02956024

P. nr.646/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës M. N. nga fsh. . . . Komuna Gjakova ,për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.6-1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë PP/II nr. 1802/21 të dt.16.12.2021,në shqyrtimin e fillestar të mbajtur më datë **22.04.2022**, në prani të Prokurorit së shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

E akuzuara **M. N.** nga fsh. . . . K Gjakovë ,data e lindjes . . . në Prishtinë ,e bija e P. dhe i nënës P. e gjinisë K. ,, ka te kryer shkollën fillore ,e gjendjes se dobët ekonomike, e pa punë , e shkurorëzuar nenën e 3 fëmijëve, shqiptare , shtetase e R. Kosovës ,me nr. te ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-me datë 07.07.2020, 19.09.2020 dhe 29.01.2021, në shtëpinë e tij, në fshatin . . . Komuna Gjakovë, me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, në vazhdimësi ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrolleve nga ana e zyrtarëve të . . .-it, në datat e lartcekur është konstatuar se i pandehuri, në njehsorin elektrik me numër 32597379, ka qenë i shkyçur, nga AMR-ja, mirëpo ka bërë lidhje direkt në rrjetin elektrik, dhe me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç 'rast ndërmarrjes së dëmtuar . . .-distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në vlerën prej 577.20 €.

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par 5 ,73 ,neni 314 par. 6 -1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 4(katër) muaj**, i cilit dënim nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara . . .-Distrikti në Gjakovë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr. 1802/21 të dt.16.12.2021 ,e ka akuzuar të akuzuarën M. N. nga fshati . . . Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale në vazhdimësi nga neni 314 par.6 -1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së .

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.22.04.2022 lexoi aktakuzën PP/II nr. 1802/21 të dt.16.12.2021, me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

E akuzuara M. N. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me ,thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer për shkak të gjendjes së dobët ekonomike me qene se në atë shtëpi kam jetuar unë me fëmijët e mi dhe vjehrrën ,e cila ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe se në pamundësi të sigurimit të mjeteve për jetesë pasi që me bashkëshortin kam qene e shkurorëzuar që nga viti 2017 dhe se i njëjti nuk ja jetuar në Kosovë , jam detyruar që vetëm të jetojë në atë shtëpi që mos të mbes rrugëve me tre fëmijë të mitur, po ashtu shtojë se që nga muaji nëntor 2021 me forcë jam larguar nga shtëpia e ish bashkëshortit dhe tani jetojë në shtëpi të sigurt në Gjakovë që 6 muaj, andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme ,kërkim falje nga e dëmtuara, gjendjen e dobët ekonomike si nënë vetushqyese e tre fëmijëve, e pa strehë , te me shqiptojë një dënim me të butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu e akuzuara M. N. , pasi që të njëjtit pranimin e fajësisë e ka bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion pas sqarimeve të mjaftueshme edhe nga ana gjykatës ,po ashtu aktakuza ka mbështetje në provat personale dhe material në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në diapozitiv ,ndërsa sa i përket kompensimit të edemit e dëmtuara të udhëzohet në kontest civil.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara M. N. : -me datë 07.07.2020, 19.09.2020 dhe 29.01.2021, në shtëpinë e tij, në fshatin . . .Komuna Gjakovë, me qëllim që vetës t’i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, në vazhdimësi ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrolleve nga ana e zyrtarëve të . . .-it, në datat e lartcekur është konstatuar se i pandehuri, në njehsorin elektrik me numër 32597379, ka qenë i shkyçur, nga AMR-ja, mirëpo ka bërë lidhje direkt në rrjetin elektrik, dhe me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar . . .-distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material

në vlerën prej 577.20 €. **-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.**

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara e cila ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjatë pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se ne veprimet e te akuzuarës formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpalle fajtores dhe ta gjykojë në bazë të ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të saj .

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysht të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar personalitetin e të akuzuarës ,është nënë vetë ushqyese e 3 fëmijëve të mitur , sjelljen e saj korrekte në gjykim , gjendjen e dobët ekonomike pasi është shfrytëzuese dhe përfituese e strehimit në Strehimoren në Gjakovë . Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, shprehjen e keq ardhjes nga e dëmtuara për veprën e kryer për shkak të gjendjes se dobët ekonomike , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së. Gjykata të akuzuarës i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se ky sanksion do të ndikoj tek e akuzuara që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarën për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike .

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-ës , pasi që e akuzuara është shfrytëzues dhe përfituese në strehimoren “Shtëpia e Sigurtë “në Gjakovë , e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarës ose të personave që ajo detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.646/21më datë 22.04.2022.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh,** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.